



Ekskluzive vetëm në Airtour

ORANGE COUNTY 5* UAI

18.06.12
7 netë 9 netë
765€ 899€

IC GREEN PALACE 5* HAI

18.06.12
7 netë 9 netë
805€ 950€

Ma lirin TURQI se n'shpi

18 qershor 7 netë

420€

SELMIHAN HOTEL KEMER 3* AI

449€

GALAXY BEACH ALANYA 4* AI

465€

ELITE LIFE KEMER 4* AI

(2 fëmijë GRATIS, deri në 12.99)

644€

ASTERIA ELITA RESORT SIDE 5* UAI

(2 fëmijë GRATIS, deri në 14.99)

7 netë 9 netë 7 netë
18.06.12 18.06.12 20.06.12

PALMET RESORT KEMER 5* UAI
744€ 870€ 744€

GELIDONYA HOTEL KEMER 4* AI
518€ 590€ 528€

CESAR RESORT SIDE 5* UAI
650€ 756€ 656€

VIKINGEN QUALITY ALANYA 5* UAI
675€ 793€ 695€

AKKA ANTEDON KEMER 5* UAI
786€ 926€ 786€

CLUB CALIMERA SERRA SIDE 5* UAI
689€ 805€ 703€

AKKA-ALINDA KEMER 5* UAI
679€ 790€ 682€

HAPPY ELEGANT ALANYA 5* AI
484€ 536€ 484€

GRAND RING KEMER 5* AI
597€ 683€ 730€

Emërimi i gjyqtarëve kushtetues, i politizuar dhe i dështuar

Kryetari i Komisionit për ndryshimin e Kushtetutës, Arsim Bajrami, ka potencuar se historia e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka reflektuar gjithmonë politikë

vijon nga ballina

Duke përkthyer themelimin e Kushtetueses, Bajrami ka potencuar se përbërja e parë e kësaj gjykate është krijuar mbi një marrëveshje politike për t'i kënaqur partitë në pushtet dhe opozitën.

"Të katër gjyqtarët kosovarë janë zgjedhur me një vendim unik që nuk ka qenë edhe fort kushtetues, me një marrëveshje politike. Në një mënyrë të gjithë janë pajtuar dhe procesi ka shkuar me një votim të vetëm dhe të katërtët kanë dalë gjyqtarë të Kushtetueses. Nëse atëherë ka pasur një arsye, edhe pse kurrë s'ka arsye të abuzohet procedura kushtetuese, tani më së paku ka arsye që të improvizojmë", ka thënë Bajrami.

Osman Ismaili, profesor në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës, e ka cilësuar Gjykatën Kushtetuese si "ajkën e së drejtës", e cila kërkon përkushtim profesional e pavarësi totale, për të cilat ka thënë se në realitet nuk ekzistojnë në Kosovë. "Nuk mund ta kuptoj, si një kuvend ta

zhvlerësojë shkencën në atë nivel. E kanë pasur njeriun i cili mendoj se është më meritori, i cili ka doktoruar në këtë drejtim dhe ka rënë në balotazh me një kandidat tjetër. Ky është një zhvlerësim total i gradës shkencore", ka thënë Ismaili.

Profesorin Ismaili e ka parë si anomali dhe si turp faktin që një asistente të zgjidhet gjykatëse e Kushtetueses, e një profesor të mos zgjidhet. "Unë me qenë asistent i profesorit, nuk kisha lejuar veten me një konkurrencë me profesorin, ngase është respekt i vlerave, respekt që ta ka dhënë mësimin", ka shtuar ai. Ismaili i ka sugjeruar të gjithë ata të cilët dëshirojnë që t'i ndihmojnë dikujt, ta bëjnë atë duke i orientuar njerëzit në vendet ku mund të japin kontribut, e jo aty ku nuk duhet e nuk mundin. "Unë si profesor kam marrë mesazhe për të intervenuar në këtë proces edhe pse s'jam në Parlament, imagjinoni ata që janë në Parlament, ka bërë të ditur Ismaili. Ai i ka vlerësuar si manipulime edhe zgjedhjet e kohëve të fundit për kryetar komi-

nash, duke thënë se është e pakuptimtë që për nëntë muaj, aq sa u ka mbetur mandat, të organizohen zgjedhje në të cilat shpenzohen mijëra para pa lidhje, përdorin pushtetin mund ta mbështesë zëvendësi i kryetarit.

Ndërsa Florent Muçaj, nga ISPK-ja, ndër të tjera ka prezantuar edhe rekomandimet e studimit të këtij instituti lidhur me emërimet e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Muçaj ka thënë se duhet të ndryshohet ligji aktual për Gjykatën Kushtetuese, dispozitat për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe se duhet të themelohet Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për gjyqtarë kushtetues.

Po ashtu në studimin e ISPK-së thuhet se komisioni përkatës i Kuvendit që rekomandon kandidatët duhet të ndryshojë përbërjen e tij, sepse përbërja e aktuale nuk garanton profesionalizëm dhe depolitizim të procesit të zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues. "Përbërja e këtij Komisioni duhet të jetë e atillë që të reflektojë paanshmëri poli-



"Figura e gjyqarit kushtetues është shumë e rëndësishme, ai ka autoritet gati sa presidenti dhe opinioni ka nevojë me pa figurën e gjyqarit, i cili s'duhet të jetë fanatik i partive politike", ka thënë Arsim Bajrami

tike dhe profesionalizëm. Komisioni duhet të ketë më shumë përfaqësues të gjyqësorit dhe të institucioneve akademike, njohës të çështjeve juridike në përgjithësi", thuhet në raportin e këtij instituti.

Ndërsa Besa Luzha, përfaqësuese e fondacionit "Friedrich Ebert Stiftung", i cili ka mbështetur publikimin e ISKP-së, e ka cilësuar si shumë shqetësues faktin që deputetët e Kosovës nuk e kanë një motivim personal dhe një dëshirë për të kontribuar në pavarësimin e gjyqësorit, si dhe funksionalizimin e institucioneve të pavarura. "Kjo është një shenjë për alarm për tërë shoqërinë", ka thënë Luzha.

Jahjaga dekoroi 30 personalitete vendore e ndërkombëtare

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Me rastin e 12 Qershorit, Ditës së Lirisë të Republikës së Kosovës, presidentja Jahjaga mori vendim për të dekoruar një numër personalitetesh të vendit dhe ndërkombëtare. Vendimi për dekorim u mor në bazë të nenit 84 pika 28 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 dhe 9 të Ligjit për dhënien e dekoratave nga presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të Rregullores mbi llojet e dekoratave që i jep presidenti i Republikës së Kosovës dhe procedurat për dhënien e tyre, si dhe në bazë të raportit të Komisionit Vlerësues për dhënien e dekoratave. Dekoratat u dhanë për këto personalitete:

Xhevat Ahmet Berisha dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërië për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; Hakif Zejnullahu dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërië për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; Edmond Hoxha dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërië për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; Agron Rama dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërië për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; Mehë Ramë Uka dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërië për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; Rrahim Samiu-ZOGU dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË, për kontributin e lartë për liri të Kosovës; Shemsi Ahmeti dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërië për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; Shefko Salković dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërië për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; Ismet Asllani dekorohet me dekoratën URDHRI HERO I KOSOVËS, për vepra sakrificë dhe trimërië për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës; Mulla Idriz Gjilani dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË,

ratën URDHRI I LIRISË, për kontributin e lartë për liri të Kosovës; Shemso Ferri dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË, për kontributin e lartë për liri të Kosovës; Shyhrete Berisha dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË, për kontributin e lartë për liri të Kosovës; Ylfe Humolli dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË, për kontributin e lartë për liri të Kosovës; Vjollca Berisha dekorohet me dekoratën URDHRI I LIRISË, për kontributin e lartë për liri të Kosovës. Sale Jashari dekorohet me dekoratën URDHRI LUFITETAR I LIRISË "ADEM JASHARI", për trimërië në luftën për liri. Nekihe Kelmendi dekorohet me dekoratën URDHRI PËR PAQE, DEMOKRACI DHE HUMANIZËM "DR. IBRAHIM RUGOVA", për veprën jetësore si kontribut i veçantë për ndërtimin e paqes, zhvillimin e demokracisë, dhe kultivimin e humanizmit; Viktor Meier, dekorohet me dekoratën URDHRI PËR PAQE, DEMOKRACI DHE HUMANIZËM "DR. IBRAHIM RUGOVA", për veprën jetësore si kontribut i veçantë për ndërtimin e paqes, zhvillimin e demokracisë, dhe kultivimin e humanizmit; Sehadete Mekuli, dekorohet me dekoratën MEDALJA HUMANITARE "NËNA TEREZË", për kontributin e dhënë në çështjet humanitare; Nurije Zekaj dekorohet me dekoratën URDHRI E PAQES DHE PAJTIMIT "ANTON ÇETITA", për kontributin e dhënë për paqen dhe pajtimin midis njerëzve; Drita Begragca dekorohet me dekoratën MEDALJA PRESIDENCIALE E MERITAVE, për kontributin e dhënë në fushën e arsimit; Walter Happer dekorohet me dekoratën MEDALJA PRESIDENCIALE E MERITAVE, për kontributin e dhënë në fushën e arsimit; Safete Rugova dekorohet me dekoratën MEDALJA PRESIDENCIALE E MERITAVE, për kontributin e dhënë në fushën e arsimit; Katarina Josipi

Topi dekoron personalitete nga Kosova

TIRANË ME 11 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Bamir Topi, ka dekoruar të nënën personalitete të shquara nga Kosova për kontributin e dhënë. Dekorimi përkon edhe me përvjetorin e 134-të të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në përvjetorin e 13-të të çlirimit të Kosovës dhe në 100-vjetorin e shtetit shqiptar. Në ceremoninë e dekorimit kanë marrë pjesë personalitete të Kosovës që janë dekoruar nga presidenti i Shqipërisë, si dhe familjarët të peronave të dekoruar që nuk jetojnë.

Topi ka dekoruar Adem Jasharin (pas vdekjes) me Urdhrin e Flamurit Kombëtar për heroizmin për mbrojtjen e çështjes kombëtare. Adem Demaçi u dekorua me Urdhrin Nderi i Kombit. Gjithashtu, Topi dekoroi me Medaljen e Artë të Shqiponjës Ramiz Cernicën (pas vdekjes) për kontributin e dhënë në luftën e Kosovës.

"Gjatë viteve të mia në funksionin e ndëruar të kryetarit të Shtetit shqiptar kam pasur fatin dhe rastin të nderoj shumë personalitete të shquara shqiptare për kontributet e tyre jetësore, aktet e kurajës së jashtëzakonshme dhe veprat e mëdha që kanë bërë për vendin. Unë sot ndihem krenar që në emër të Shtetit shqiptar nderoj me dekoratën më të lartë Adem Jasharin, heroin legjendar të luftës për çlirimin e Kosovës, prijësin fjalëpakë dhe simbolin frymëzues për miliona të rinj shqiptarë, njeriun që tashmë e nderon përjetë çdo familje, çdo qytet e çdo komunitet shqiptar në botë. Unë gjithashtu ndihem krenar që kam rastin të nderoj heronjtë e tjerë të Kosovës së re: Fehmi Lladrovcin dhe bashkëshorten e tij Xhevën; Ukshin Hotin dhe Afrim Zhitinë, si dhe emra të tjerë të shquar deri tek mjeshtrit e pavdekshëm të fjalës dhe zërit, Sulejman Krasniqi dhe Dervish Shaqa, por më lejoni të veçoj në nderimin e sotëm një emër simbol dërdre dhe disidencë, një intelektual atdhetar dhe qytetar, shkrimtarin dhe veprimtarin e të drejtave të njeriut, "Mandelërin e lirisë" dhe heroin e gjallë të Kosovës, Adem Demaçin. Miku im Adem, jemi me fat që ju kemi sot midis nesh. Ju kenë qenë dhe jeni nderi i kombit shqiptar, por nga sot edhe zyrtarisht e meritoni këtë titull të

me motivacionin: "Luftëtarit antitafshist, veprimtar trim dhe kurajoz për të drejtat kombëtare dhe njerëzore të popullit shqiptar të Kosovës, i cili u përball derisa dha jetën me represionin e egër dhe torturat çnjerëzore të shtetit shovinist në ish-Jugosllavi", Kadri Hailim (pas vdekjes) me motivacionin: "Për trimërinë, guximin në qëndresën dhe rezistencën ndaj politikave antishqiptare të shtetit në ish-Jugosllavi, për veprimtarinë atdhetare në mbrojtje të të drejtave të popullsisë shqiptare të Kosovës për vetëvendosje dhe pavarësi"; Ali Aliun (pas vdekjes) me motivacionin: "Për veprimtarinë të përshtur atdhetare, në mbrojtje të të drejtave kombëtare dhe njerëzore të popullit shqiptar të Kosovës, nën represionin e egër shtetëror shovinist, duke u bërë shembull frymëzimi për brezat e rinj të Kosovës"; Sami Pejën (pas vdekjes) me motivacionin: "Për veprimtarinë të përshtur atdhetare për çështjen kombëtare të fitores së pavarësisë së Kosovës, duke u përballur me represionin e egër të shtetit shovinist e që mbeti deri në vdekje shembull i patriotit të papërkulur"; Metush Krasniqin (pas vdekjes) me motivacionin: "Për qëndresë të papajtueshme me politikën shoviniste antishqiptare, për veprimtarinë të përshtur atdhetare për zgjidhjen e çështjes kombëtare të popullsisë shqiptare të Kosovës, duke u përballur me represionin e egër dhe torturat çnjerëzore të shtetit shovinist"; Hyrije Hanës (pas vdekjes) si: "Veprimtar atdhetar që ia kushtoi jetën e saj luftës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës dhe çështjes së të drejtave kombëtare të popullsisë shqiptare"; Fazli Graicevcin (pas vdekjes) si: "Intelektual i angazhuar që gjithë jetën ia kushtoi çështjes së të drejtave kombëtare dhe njerëzore të popullit shqiptar të Kosovës duke u përballur deri në vdekje me represionin e egër dhe torturat çnjerëzore të shtetit shovinist në ish-Jugosllavi"; Zija Shemsun (pas vdekjes) me motivacionin: "Një nga organizatorët heroikë të rezistencës së studentëve dhe të gjithë popullit shqiptar të Kosovës ndaj shtypjes së të drejtave kombëtare e njerëzore nga shteti shovinist në ish-Jugosllavi i cili u nën-